



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI KONTRAKTOR**  
**BASHKIA PATOS**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më \_\_\_/\_\_\_/2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK I**  
**SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Datë: 12/04/2021

Për: "**Genti 001**" Shpk Patos

Patos, Fshati Sheqishte, Rruga e Qendrës, godina 64

Procedura e prokurimit: "**Tender i hapur**" Marrëveshje kuadër me nje operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara".

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-86331-02-08-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj*]

**"Blerje rërë bituminoze për shtrim rrugësh".**

**Sasia e pritshme e mallit që kërkohet:**

Nr	Nr.analize	Emëtrimi i materialit	Njësi	Sasi
1	(102,Man.1+an)	Blerje rërë bituminoze	ton	7152
2	(3.212/b)	Blerje granili	m <sup>3</sup>	435

**Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër është 36 muaj nga nënshkrimi i saj.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*]

[*Numri*]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

- Shoqëria "BEQIRI" sh.p.k Fier, me nr. NIPT-i J98624801V, ofron vlerën sipas preventivit **11,218,650 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë ) lekë pa TVSH.**
- Shoqëria "GENTI 001" sh.p.k Patos, me nr. NIPT-i L93101401U, ofron vlerën sipas preventivit **11,978,328 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e njëzetë e tetë ) lekë pa TVSH.**

- Shoqëria “SARK” sh.p.k Fier, me nr. NIPT-i K52531415H, ofron vlerën sipas preventivit **11,076,000 (njëmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë ) lekë pa TVSH.**

#### **Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:**

- Shoqëria “BEQIRI” sh.p.k, me nr. NIPT-i J98624801V, ofron vlerën sipas preventivit **11,218,650(njëmbëdhjetë milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë ) lekë pa TVSH.**ka mungesë të dokumentacionit si më poshtë :
  - Nuk plotëson pikën 5.1. Punën e ngjashme  
Operatori ka si punë të ngjashme punë të kryera dhe jo furnizime të ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit për zërin e kërkuar
  - Nuk plotëson pikën 6.2 ku kërkohet që operatori të ketë kontratë furnizimi me prodhuesin e rërës bituminoze i cili duhet të ketë dokumentacion për shfrytëzim karriere rëre bituminoze  
Operatorit i mungon vetëdeklarimi ku të shprehet se prodhuesi I mallrave të ofruar I disponon lejet e kërkuara
  - Nuk plotëson pikën 7.3. Mjete dhe pajisje teknike
    - 1.Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton copë 2  
Plotëson vetëm 1 copë. Mjeti me qera AA086OE ka peshën mbajtëse 19 200kg
    - 2.Kokë tërheqëse + gjysmë rimorkio vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës mbi 20 ton copë 1  
Nuk plotëson asnjë nga 2 copë që ka hedhur  
Mjeti kokëtërheqës AA993AS I mungon certifikata e transportit kurse rimorkio ADR 203 është rimorkiator dhe jo vetëshkarkuese dhe nuk ka certifikatë transporti  
Mjeti AA642LH kokëtërheqës me qera, I ka skaduar siguracioni dt.02.03.2021
- Shoqëria “SARK” sh.p.k, me nr. NIPT-i K52531415H, ofron vlerën sipas preventivit **11,076,000(njëmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e gjashtë mijë ) lekë pa TVSH**ka mungesë të dokumentacionit si më poshtë :
  - Nuk plotëson pikën 4.a. Vërtetim për taksat dhe tarifatat kudo ku ushtrohet aktivitet sipas regjistrimit në QKB.  
*Operatori ushtron aktivitet në Tiranë por nuk ka sjellë vërtetim për likuidimin e taksave 2020 (ka faturat që ka paguar)*
  - Nuk plotëson pikën 6.2 ku kërkohet që operatori të ketë kontratë furnizimi me prodhuesin e rërës bituminoze I cili duhet të ketë dokumentacion për shfrytëzim karrier rëre bituminoze  
*Operatoi ka lidhur kontratë me kompaninë FIAM-A e cila në dokumentat e hedhura tregon se ka fabrikë asfalto betoni dhe jo karrier shfrytëzim rëre, si dhe kompania ARDMIR e cila ka leje minerare për shfrytëzim guri gëlqeror.*
  - Nuk plotëson pikën 7.3. Mjete dhe pajisje teknike
    - 1.Kamion vetëshkarkues 5-10 ton copë 2  
Nuk ka hedhur asnjë
    - 2.Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5ton copë 2

Nga 2 copë plotëson vetëm 1 copë

Mjeti me targa AA644TO nuk ka certifikatë pronësie dhe nuk është kamioncinë.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **informojmë se është identifikuar si operator ekonomikë i suksesshëm:**

Shoqëria “GENTI 001” sh.p.k Patos, me nr. NIPT-i L93101401U me adresë Patos, Fshati Sheqishte, Rruga e Qendrës, godina 64 ofron vlerën sipas preventivit **11,978,328 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e njëzetë e tetë ) lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë Bashkise Patos, brenda **5 dite** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : **02/04/2021**

Ankesa: ka ose jo **NUK KA**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë

**KRYETARE**  
Rajmonda **BALILAJ**